



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 291, Datë 09.10.2023**

**MBI**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 188, DATË 16.11.2020,  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KAMIÇAN”, ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 1860 KW”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2033/14 prot., datë 04.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.188, datë 16.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kamiçan”, me kapacitet të instaluar 1860 KW”, i ndryshuar”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 188, datë 16.11.2020, të ndryshuar, vendosi të licencojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamiçan”, me kapacitet të instaluar 1860 kW, për një afat 30 vjeçar, duke i lënë kushtin që të depozitohet në ERE brenda datës 25.10.2023, lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan”.
- ERE me shkresën me nr. 2033/10 prot., datë 22.09.2023 i kujtoi shoqërisë detyrimin e lënë në pikën 2 gërma “b” të vendimit të bordit nr. 188/2020 që brenda datës 25.10.2023, duhet të depozitohet lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan”.

- Me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2033/12 prot., datë 29.09.2023 shoqëria ka depozituar lejen e përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor me nr. Serie 000128, nr.642 prot., datë 05.07.2023, të miratuar me vendimin nr. 23, datë 29.06.2023, të Këshillit të Basenit Ujq Seman për përdorimin e burimit ujq për HEC “Kamiçan”, me një afat 5-vjeçar, deri më 29.06.2028.
- Me depozitimn e këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 gërma “b” të vendimit nr. 188/2020, i ndryshuar, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe po ashtu, i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kushtin shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan” brenda datës 29.06.2028.
- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 188, datë 16.11.2020, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:
  2. *Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. të depozitojë në ERE:*
    - b. Brenda datës 29.06.2028, lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan”.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 291, Datë 09.10.2023

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 188, DATË 16.11.2020,  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KAMIÇAN”, ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 1860 KW”, I NDRYSHUAR**

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Erjola Sadushi

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Maksim Shuli

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Raimonda Islamaj

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Petraq Lika

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_